



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 251 prot.

Tiranë, më 17.04 2019

VENDIM

Nr. 76, Datë 17.04.2019

PËR

**SHPALLJEN E REZULTATEVE TË VOTIMIT PËR ANËTARIN E BORDIT TË
ADMINISTRIMIT TË UMT-SË, VOTUAR NGA STUDENTËT**

Komisioni Institucional Zgjedhor i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë në mbledhjen e tij, datë 17.04.2019, me pjesëmarrjen e:

Irena Korita	Kryetar
Leart Berdica	Anëtar
Enkeleda Sinaj	Anëtar
Alketa Qosja	Anëtar
Gerta Kaçani	Anëtar
Artur Xhumari	Anëtar
Matina Çobo	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Shpalljen e Rezultatit të Zgjedhjeve për anëtar të Bordit të Administrimit të UMT-së, përfaqësues i MASR-së, që votohet nga studentët e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

Baze ligjore: Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor...”, VKM nr. 782, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kritereve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të BA ...”.

Komisioni Institucional Zgjedhor pasi shqyrtoi dokumentacionin e marrë në dorëzim nga KZF-të e Fakultetit të Mjekësisë, Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike dhe Fakultetit të Mjekësisë Dentare Tabelat e Rezultateve për kategorinë Studentë të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

VËREN:

Se më datë 16.04.2019, me Vendimin e KIZ-së nr.73, datë 08.04.2019, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë u zhvilluan zgjedhjet për anëtar të Bordit të Administrimit të UMT-së,

përfaqësues i MASR-së, që u votua nga studentët e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

KZF-të hartuan tabelat përfundimtare të rezultatit të votimit për anëtar të Bordit të Administrimit të UMT-së, përfaqësues i MASR-së, që votohet nga studentët e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit zyrtar dhe të dhënat e sjella nga KZF-të: Fakultetit të Mjekësisë Dentare, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike dhe Fakultetit të Mjekësisë, KIZ-i i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë disponon rezultatin e zgjedhjeve për anëtar të Bordit të Administrimit të UMT-së, përfaqësues i MASR-së, që votohet nga studentët e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, dhe shpall rezultatin e votimit bazuar në këto të dhëna.

Bashkëlidhur tabela e përlogaritjeve të rezultatit të votimit anëtar të Bordit të Administrimit të UMT-së, përfaqësues i MASR-së, që votohet nga studentët e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

Sa më sipër Komisioni Institucional Zgjedhor i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

VENDOSI:

1. Të shpallë rezultatin e votimit për kandidatët për anëtar të Bordit të Administrimit të UMT-së, përfaqësues i MASR-së, që votohet nga studentët e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, sipas tabelës nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe shpallet në abjentet e Universitetit të Mjekësisë, Tiranë ku KIZ ka selinë e tij dhe në faqen zyrtare të internetit të UMT-së.



Tabela nr. 1

ANËTARËT E BORDIT TË ADMINISTRIMIT TË UMT-së, PËRFAQËSUES TË MASR-së, TË VOTUAR NGA STUDENTËT E UMT-së

Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. votave
1.	ARETI	THANAS	STRINGA	37 (tridhjet e shtatë)
2.	EDI	QIRIC	GRABOCKA	37 (tridhjetë e shtatë)
3.	ROBERT BEQAR		SKËNDERI	20 (njëzet)

**KRYETAR
IRENA KORITA**

